



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA SHETËTORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DRZAVNA AGJENCIA ZA ZAŠTITU LICNIH PODATAKA
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA
ZVRA E ARKIVIT - KANCELARIA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE

Njësim Org. 01 Nr. Prot. 263
Org. Jedin. Br. Prot.
Org. Unit Prot. No.

Nr. i faqeve 03 Data 06,12,2013
Brey stranic No. pages: Date:

PRISHTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agjencia za Zastitu Licnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

DATË/A:	05 DHJETOR 2013
REFERENC-Ë:	/2013
PËR/ZA/TO:	z. Rina Gojani, Zyrtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale / Banka Ekonomike
CC:	z. Ilir Aliu, Drejtor Ekzekutiv / Banka Ekonomike
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Ruzhdi Jashari, Mbikqyrës Kryesor Shtetëror
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi për autorizim

E nderuar znj. Gojani,

Bazuar në kërkesën tuaj për dhënien e autorizimit për transferimin e të dhënave personale nga Banka Ekonomike SH.A. te Compass Plus LTD - Processing Center me seli në Rusi, Këshilli i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka shqyrtuar kërkesën tuaj dhe ka marrë vendimin për autorizimin e transferimit.

Të bashkangjitur gjeni vendimin Nr.02/17 të datës 04.12.2013.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Pödataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr.02/17

Datë: 04.12.2013

Në mbështetje të nenit 30 (paragrafi 1 dhe 2), nenit 57 (paragrafi 1 dhe 2) të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 7 (paragrafi 9) i Rregullores së Punës Nr.20/2011 të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur më 04.12.2013, mori:

V E N D I M

1. Miratohen kërkesa për autorizimit e transferimit të të dhënave personale nga Banka Ekonomike SH.A. te Compass Plus LTD - Processing Center me seli në Rusi.
2. Obligohet Banka Ekonomike SH.A. që me rastin e transferimit të këtyre të dhënave të i përmbahet dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

Arsyetim


Me datë 01.10.2013 Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme Agjencia) ka pranuar një kërkesë nga Banka Ekonomike SH.A. për lejimin e autorizimit për transferim të të dhënave personale në Compass Plus LTD - Processing Center me seli në Rusi.

Banka Ekonomike SH.A ka ofruar një pjesë të kontratës me nr. S2804/2009(5.36) në mes të Bankës Ekonomike dhe Compass Plus LTD, ku pika 8 rregullon konafidencialitetin dhe ceket përkushtimi i palëve kontraktuese për të mbrojtur rreptësisht të gjitha informatat konfidenciale dhe të mos i zbuloj tek pala e tretë.

Banka Ekonomike SH.A. ka ofruar edhe dëshmi mbi masat mbrojtëse të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale përmes certifikatave të pajtueshmërisë me standardet e sigurisë (PCI DSS) për 3 vite (2010,2011,2012) si dhe formularin ku jepen detajet e qëllimit të transferimit të të dhënave personale që është realizimi i transaksioneve ndërkombëtare me kartela visa dhe master card, ku është i pamundur që të realizohet pa transferim të të dhënave në mes të palëve të përfshira.

Në bazë të dëshmive të lartëcekura, dhe bazuar në neni 30, nenit 57 (paragrafi 1 dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 7 (paragrafi 9) i Rregullores së Punës Nr. 20/2011, Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur me datë 04.12.2013 autorizon Bankën Ekonomike SH.A. për transferimin e të dhënave personale në Compass Plus LTD në Rusi duke përfshirë kategoritë e të dhënave, qëllimin e transferimit dhe masat mbrojtëse në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ruzhdi JASHARI



Vendimi i dërgohet:

- Bankës Ekonomike Sh.A.
- Anëtarëve të Këshillit
- Arkivit të Agjencisë